



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.:1699/24 Datë: 20.08.2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr.13/29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 127 të mbajtur më datë 12.08.2024 Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohet programi i studimit i Fakultetit të Arteve në Universitetin e Prishtinës për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2027):
 - *Master i Muzikës në Edukim MMus 120 ECTS R, me kuotën maksimumi 20 studentë për vit akademik;*
- II. Numri i studentëve zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- III. Obligohet Fakulteti i Arteve në Universitetin e Prishtinës që deri më datë 15.11.2024 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- IV. Obligohet Fakulteti i Arteve në Universitetin e Prishtinës të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Ndryshimi i bartësve bëhet vetëm me vendim nga KShC.
- V. Institucioni i Arsimit të Lartë mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Fakulteti i Arteve në Universitetin e Prishtinës brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për riakreditimin e programeve të studimeve me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	Master i Muzikës në Edukim MMus 120 ECTS R	Besa Luzha Rreze Kryeziu Breznica

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit në Fakulteti i Arteve në Universitetin e Prishtinës, AKA ka organizuar vizitat me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit: Branko Matulic, Darko Lukic dhe Christoph Back.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

Për programin e studimit; Master i Muzikës në Edukim MMus 120 ECTS R, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më 26.06.2024 të cilët në raport përfundimtar kanë konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht një (1), Substancialisht pesë (5) dhe Plotësisht një (1) fusha të standardeve.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 127-të, të mbajtur më datë 12.08.2024, ka shqyrtuar dokumentacionin relevant të Fakultetit të Arteve në Universitetin e Prishtinës dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatën prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.

Vendimi iu dërgohet:

- Fakulteti i Arteve në Universitetin e Prishtinës;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,

Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë